



# *COMARC/H*

## *Formati për të dhënat e koleksioneve*

*Manual për përdoruesit*



United Nations  
Educational, Scientific and  
Cultural Organization

Regional Centre for  
Library Information Systems and  
Current Research Information Systems  
Regionalni center za knjižnične  
informatijske sisteme in informatijske  
sisteme o raziskovalni dejavnosti



© IZUM, 2018

IZUM, COBISS, COMARC, COBIB, COLIB, CONOR, SICRIS, E-CRIS janë marka të regjistruara në pronësi të institucionit publik IZUM.

Marka të tjera të përdorura janë në pronësi tjetër.

Manuali përmban të gjitha përditësimet nga botimi i versionit të parë në vitin 1992 deri sot. Përmbajtja është në përputhje me programin COBISS3, V6.20-00, dhe vlenë për të gjitha versionet në vazhdim të programit, deri në anulimin ose botimin e versionit të ri të manualit në formë elektronike.

© IZUM, ndryshimet e fundit të përmbajtjes: nëntor 2018, përkthyer në gjuhën shqipe: gusht 2021

ISSN 2463-9680

# PËRMBAJTJA

**HYRJE .....HYRJE - 1**

**STRUKTURA E TË DHËNAVE PËR GJENDJEN E KOLEKSIONEVE ..... STRUKTURA - 1**

Të dhënat për gjendjen e koleksioneve bazuar në standard ..... STRUKTURA - 1

Niveli i përbashkët dhe lokal i të dhënave për gjendjen e koleksioneve..... STRUKTURA - 2

Madhësia e të dhënave në nivelin e përbashkët ..... STRUKTURA - 3

Madhësia e të dhënave në nivelin lokal ..... STRUKTURA - 5

**998 TË DHËNAT PËRMBLEDHËSE PËR KOLEKSIONET..... 998 - 1**

**997 TË DHËNAT PËR GJENDJEN E KOLEKSIONEVE TË SERIALEVE ..... 997 - 1**

**996 TË DHËNAT PËR GJENDJEN E KOLEKSIONEVE TË MONOGRAFIVE..... 996 - 1**

**99X TË DHËNAT PËR GJENDJEN E KOLEKSIONEVE ..... 99X - 1**

Lista e fushave..... 99X - 1

998 a – Data e raportimit..... 998 a - 1

998 b – Kodi i institucionit..... 998 b - 1

996/997 c – Identifikuesi i kopjes/njesisë së kompletit..... 996/997 c - 1

998 c – Numri i kopjeve ..... 998 c - 1

99X d – Numri i vendit (Vendosja)..... 99X d - 1

996/997 e – Rivendosja e materialit..... 996/997 e - 1

998 e – Treguesi i pasurimit..... 998 e - 1

996/997 f – Numri i inventarit..... 996/997 f - 1

99X g – Të dhënat e përgjithshme për koleksionet ..... 99X g - 1

996/997 h – Titulli i njesisë..... 996/997 h - 1

996/997 i – Madhësia e njesisë ..... 996/997 i - 1

997 j – Numërtimi – niveli i dytë (viti) ..... 997 j - 1

997/998 k – Viti i botimit..... 997/998 k - 1

997 l – Numërtimi – niveli i tretë..... 997 l - 1

997 m – Numërtimi – niveli i parë (numri) ..... 997 m - 1

99X n – Shënime për gjendjen e koleksioneve ..... 99X n - 1

996/997 o – Data e inventarizimit ..... 996/997 o - 1

996/997 p – Shkalla e disponueshmërisë ..... 996/997 p - 1

996/997 q – Statusi..... 996/997 q - 1

996/997 r – Shënime për inventarin ..... 996/997 r - 1

996/997 s – Lidhja..... 996/997 s - 1

996/997 t – Data e statusit..... 996/997 t - 1

996/997 u – Kufizimi i disponueshmërisë..... 996/997 u - 1

99X v – Mënyra e pasurimit..... 99X v - 1

996/997 w – Qëllimi i pasurimit.....	996/997 w - 1
996/997 x – Numri dhe data e porosisë.....	996/997 x - 1
996/997 y – Numri dhe data e pranimit.....	996/997 y - 1
996/997 z – Numri dhe data e reklamimit.....	996/997 z - 1
996/997 0 – Numri dhe data e faturës paraprake.....	996/997 0 - 1
996/997 1 – Numri dhe data e faturës.....	996/997 1 - 1
99X 2 – Furnizuesi.....	99X 2 - 1
99X 3 – Çmimi (nga fatura).....	99X 3 - 1
99X 4 – Financuesi.....	99X 4 - 1
996/997 5 – Lloji i përpunimit (orientimi).....	996/997 5 - 1
996/997 7 – Numri i brendshëm dhe data e faturës.....	996/997 7 - 1
996/997 8 – Pranuesi për dhuratë ose këmbim.....	996/997 8 - 1
996/997 9 – Numri për huazim.....	996/997 9 - 1

**SHËNIMI I TË DHËNAVE PËR SHTOJCAT (SUPLEMENTET) .....SHTOJCAT - 1**

**LITERATURA ..... LITERATURA - 1**

### Shtojcat

<b>A PËRMBAJTJA E TË DHËNAVE PËR GJENDJEN E KOLEKSIONEVE.....</b>	<b>A - 1</b>
<b>B SHKURTESA TË REKOMANDUARA.....</b>	<b>B - 1</b>
<b>C SHEMBULL I VEÇANTË I VENDOSJES SË TË DHËNAVE NË DISA NIVELE .....</b>	<b>C - 1</b>

## TABELAT

Tabela 998 c-1: Mënyra e përditësimit të nënfushës 998c dhe shfaqja e të dhënave për disponueshmërinë e koleksioneve.....	998 c - 4
Tabela 998 c-2: Tabela e lidhjeve midis të dhënave për disponueshmërinë e koleksioneve dhe statusi i huazimit .....	998 c - 5



---

# HYRJE

Në procesin e katalogimit të përbashkët COBISS në të njëjtën kohë përditësohen bazat bibliografike lokale dhe baza e përbashkët e ajo e njësuar. Bazat bibliografike përveç të dhënave bibliografike përmbajnë edhe të dhënat për koleksionet e bibliotekës.

Struktura e të dhënave në COBISS është përcaktuar përmes formatit COMARC për regjistrimin e lexueshëm nga makina, dhe atë:

- formati COMARC/B për të dhënat bibliografike
- formati COMARC/A për të dhënat e njësuara
- formati COMARC/H për të dhënat e koleksioneve

Formati COMARC/B dhe COMARC/A është ndërtuar duke u bazuar në formatin UNIMARC, i cili është një një standard ndërkombëtar dhe e zhvillon IFLA Universal Bibliographic Control and International MARC Programme (UBCIM).

Formati COMARC/H për të dhënat e koleksioneve është krijuar në IZUM, sepse në kohën kur është krijuar sistemi i katalogimit të përbashkët formati UNIMARC për të dhënat e koleksioneve ende nuk ekzistonte. Formën fillestar të formatit COMARC/H anëtarët e sistemit të përbashkët e kanë konfirmuar në mbledhjen e datës 7 dhe 8 nëntor 1989 në Maribor.

Formësimi i strukturës së të dhënave për gjendjen e koleksioneve është bazuar në analizën e të dhënave për koleksionet dhe analiza e proceseve përkatëse të punës tek pjesëmarrësit e atëhershëm aktivë të katalogimit të përbashkët. Në përgatitjen e formatit COMARC/H rol kyç kanë luajtur edhe rekomandimet e standardit ISO/TC46/SC9-N34. Tek plotësimet e mëvonshme të formatit COMARC/H janë respektuar edhe standardet e përpunimit të të dhënave për koleksionet, siç është ANSI Z39.44-1986, formati MARC 21 (më parë quhej USMARC) dhe standarde të tjera *de facto*.

COMARC/H përcakton:

- të dhënat përmbledhëse për koleksionet, të cilat ndodhen në bazën e përbashkët dhe në bazat lokale të të dhënave, të cilat mundësojnë funksionin *COBISS+* dhe funksionin e koordinimit të pasurimit për serialet;
- të dhënat e detajuara për koleksionet, të cilat ndodhen vetëm në bazat lokale bibliografike dhe mundësojnë automatizimin e procedurave të inventarizimit, huazimit, pasurimit tek monografitë, kontrollimin e ardhjes së serialeve dhe automatizimin e procedurave të tjera interne.

Formati COMARC/H i është përshtatur sistemit të katalogimit të përbashkët në COBISS, i cili është përshkruar në manualin *COBISS3/Katalogimi*. Për krijimin e regjistrimeve bibliografike dhe të dhënave të tjera për materialet bibliotekare, në kuadër të sistemit të katalogimit të përbashkët janë në dispozicion katër maska: M – monografi, K – burime në vazhdim, Z – koleksione, A – artikuj dhe pjesë të tjera

përbërëse si dhe N – materiale jolibra. Këto maska përmbajnë fusha, nënfusha dhe elemente të nënfushave, të cilat përdoren më së shpeshti gjatë përshkrimit të një materiali të nivelit të caktuar bibliografik.

Fushat përcaktohen me një varg prej tre numrash, ndërsa nënfushat me një shkronjë ose numër. Njësia më e vogël e informacionit, që njihet nga programi gjatë kërkimit dhe shfaqjes, në formatin COMARC/B dhe COMARC/A është nënfusha, ndërsa tek formati COMARC/H është elementi i nënfushës. Fushat, nënfushat, elementet dhe kodet që nuk përdoren më janë identifikuar me dy yllthe "\*\*\*".

Qëllimi i manualit *COMARC/H* është dhënja e udhëzimeve sa më të sakta për përdorimin e formatit. Përmbajtja e manualit është e ndarë në pesë blloqe dhe tri shtojca.

Në bllokun e parë është paraqitur ndarja bazë e të dhënave në të dhëna përmbledhëse dhe të dhëna të detajuara për koleksionet dhe shënimi i tyre sipas niveleve të veçanta (të përbashkëta dhe lokale).

Tri blloqet më të shkurtëra paraqesin fushat, të cilat formojnë formatin COMARC/H:

- fusha 998 – *Të dhënat përmbledhëse për gjendjen e koleksioneve*
- fusha 997 – *Të dhënat për gjendjen e koleksioneve të serialeve*
- fusha 996 – *Të dhënat për gjendjen e koleksioneve të monografive*

Në bllokun e fundit, i cili është edhe më i madhi, janë përshkruar nënfushat me elementet e veçanta, që janë të renditura sipas radhës alfabetike, pavarësisht nga fushat, të cilave u përkasin. Fillimisht është paraqitur pasqyra e të gjitha nënfushave dhe elementeve të cilat mund të ndodhen në fushat 998, 997 dhe 996, më pas është përshkruar përdorimi i treguesve tek një numër i kufizuar i fushave. Përshkrimi i nënfushave të veçanta përbëhet nga përshkrimi i përgjithshëm i nënfushës, pas të cilit vije lista e elementeve me gjatësinë më të madhe të lejuar dhe përshkrimi i elementeve, nëse nënfusha i posedon. Në fund janë dhënë edhe shembujt. Në rastet kur ndodhet edhe fusha 998, tek nënfusha 998c nuk shfaqet përmbajtja e të gjithë elementeve të kësaj nënfushë, mirëpo vetëm përmbajtja e elementit 7. Përmbajtja e të gjitha elementeve shfaqet në modulën *COBISS3/Koleksionet e bibliotekës* midis attributeve të klasës **Fusha 998** dhe klasës **Materiali**.

Pas bllokut të përmbajtjes janë këto të dhëna:

- *Shtojca A*: Përmbajtja e të dhënave për koleksionet (pasqyra e nënfushave dhe elementeve me paraqitjen e përsëritshmërisë ose jopërsëritshmërisë, shkallës së detyrueshmërisë dhe pranisë në nivelin e përbashkët dhe/ose lokal)
- *Shtojca B*: Shkurtesat e rekomanduara
- *Shtojca C*: Shembull i veçantë i shënimit të të dhënave në disa nivele

Në rast të ndryshimeve ose përditësimeve të formatit, zëvendësohen vetëm ato faqe, në të cilat janë ndryshuar. Faqet e përditësuara kanë datë të re, ndërsa anash përmbajtjes së ndryshuar ndodhet një vizë vertikale.

Lusim, të gjithë përdoruesit e këtij manuali, që me sugjerimet e tyre të ndihmojnë në përmirësimin e zgjidhjeve të realizuara deri tani.



---

# STRUKTURA E TË DHËNAVE PËR GJENDJEN E KOLEKSIONEVE

## TË DHËNAT PËR GJENDJEN E KOLEKSIONEVE BAZUAR NË STANDARD

Sipas standardit ISO ISO/TC46/SC9-N34 të dt. 15.03.1989 të dhënat për koleksionet janë të klasifikuara në tri nivele:

- **Niveli 1** në mënyrë unike përcakton njësinë bibliografike dhe institucionin që posedon njësinë bibliografike,
- **Niveli 2** përfshinë të dhënat e nivelit të mëparshëm, datën e raportimit për gjendjen e koleksioneve dhe fushën e përshkrimit të përgjithshëm (llojin e njësisë, formën fizike, plotësinë, rregullsinë, ruajtjen),
- **Niveli 3** përfshinë të dhënat e nivelit të mëparshëm dhe fushën e madhësisë së të dhënave për gjendjen e koleksioneve (emrin e njësisë, madhësinë, numërtimin, kronologjinë dhe shënimet) në formën përmbledhëse.

Bazuar në standardin ANSI Z39.44-1986 (ISSN 8756-0860) ekziston edhe niveli i katërt, i cili përfshin të dhënat e njëjta sikurse niveli 3 ISO, mirëpo në formë më të detajuar.

Struktura e të dhënave për gjendjen e koleksioneve deri në nivelin e tretë e mbështetë ndërtimin e *COBISS+*, ndërsa për automatizimin e huazimit dhe evidencat e brendshme janë të nevojshme të dhënat e detajuara, të cilat i përkasin një monografie të veçantë apo një viti të veçantë të një seriali.

Për shkak se identifikimi i njësisë bibliografike në nivelin e parë është bërë në procesin e katalogimit të përbashkët me ndihmën e ISBN-së, ISSN-së, titullit, autorit etj., në këtë material nuk është trajtuar përsëri. Struktura e të dhënave deri në nivelin e tretë (përmbledhës) është në përputhje me standardin ISO, ndërsa niveli i katërt (i detajuar) është i ndarë në bazë të analizës së proceseve informuese dhe evidencave të bibliotekave kombëtare, universitare dhe publike, të përfshira në sistemin COBISS.

## NIVELI I PËRBASHKËT DHE LOKAL I TË DHËNAVE PËR GJENDJEN E KOLEKSIONEVE

Të dhënat për gjendjen e koleksioneve vendosen në bazën lokale të të dhënave (niveli lokal) në formë përmbledhëse ose në formën e detajuar për njësinë e veçantë fizike. Në bazë të të dhënave përmbledhëse të niveleve lokale, të dhënat në sistemin e katalogimit të përbashkët transferohen në mënyrë automatike në nivelin e përbashkët në bazën e të dhënave COBIB.

Për evidentimin e të dhënave për gjendjen e koleksioneve përdoren fushat 998, 997 dhe 996:

- 998 – të dhënat përmbledhëse për gjendjen e koleksioneve,
- 997 – të dhënat për gjendjen e koleksioneve të serialeve,
- 996 – të dhënat për gjendjen e koleksioneve të monografive.

Në strukturën e paraqitur ndodhen të dhënat (bazuar në nivelin) e klasifikuara sipas grupeve, kështu që me përfshirjen e niveleve shtesë të të dhënave rritet mundësia e përdorimit të funksioneve të veçanta si: *COBISS+*, koordinimi i pasurimit, huazimi i monografive, huazimi i serialeve dhe administrimi i evidencave të brendshme. Institucionet mund të përdorin të gjitha funksionet e lartëshënuara ose vetëm disa prej tyre, varësisht nga kapacitetet kompjuterike që kanë në dispozicion.

Struktura e paraqitur mundëson edhe unifikimin e disa listave të kodeve, të cilat nuk janë vetëm të rëndësisë lokale (në kuadër të institucionit).

Në fushën 998 vendosen të dhënat në formën përmbledhëse për institucionin e caktuar. Zakonisht ky është institucioni juaj, mirëpo të dhënat përmbledhëse për gjendjen e koleksioneve mund të vendosen edhe për institucionin tjetër, për nevojat e *COBISS+* dhe për koordinimin e pasurimit.

Në fushën 997 vendosen të dhënat për gjendjen e koleksioneve të serialeve vetëm për institucionin tuaj dhe për çdo vit veç e veç.

Në fushë 996 vendosen të dhënat për gjendjen e koleksioneve të monografive vetëm për institucionin tuaj, dhe atë vetëm të dhënat që kanë të bëjnë me njësinë e veçantë fizike.

## MADHËSIA E TË DHËNAVE NË NIVELIN E PËRBASHKËT

Të dhënat për gjendjen e koleksioneve në nivelin e përbashkët vendosen në fushën 998 dhe kanë për qëllim dhënien e informacionit (*COBISS+*, koordinimi i pasurimit me seriale...) në sistemin COBISS.

Ato vendosen në këto nënfusha për:

### monografi

- b** kodi i institucionit
- c** numri i kopjeve

### seriale

- a** data e raportimit
- b** kodi i institucionit
- c** numri i kopjeve
- e** treguesi i pasurimit
- g** të dhënat e përgjithshme të koleksioneve (plotësia)
- k** viti i botimit
- n** shënime për gjendjen e koleksioneve
- v** mënyra e pasurimit
- 2** furnizuesi
- 3** çmimi (nga fatura)
- 4** financuesi

Nënfusha 998e shtohet në mënyrë automatike në bazë të të dhënave në nënfushën 998k.

Të dhënat e institucioneve të veçanta (kodet) transferohen në mënyrë automatike në nivelin e përbashkët, bazuar në të dhënat e vendosura në bazën lokale të të dhënave.

Tek monografitë, në bazë të të dhënave për njësinë(të) e veçantë(ta) fizike – polja(t) 996 formohen të dhënat përmbledhëse – fusha 998, të cilat regjistrohen në bazën lokale të të dhënave dhe në të njëjtën kohë në mënyrë automatike transferohen nga niveli lokal në atë të përbashkët. Nëse të dhënat për njësinë(të) e veçantë(ta) fizike nuk regjistrohen, të dhënat përmbledhëse vendosen drejtpërdrejt në fushën 998 në bazat lokale të të dhënave, prej nga në mënyrë automatike transferohen në nivelin e përbashkët.

Edhe tek serialet fusha 998 shtohet në mënyrë automatike, kur në regjistrim për herë të parë vendosni të dhënat e detajuar për koleksionet - fushën 997. Në fushën 998 në mënyrë automatike vendoset e dhëna në nënfushën 998b (kodi i institucionit) dhe në nënfushën 998c (numri i kopjeve). Më vonë të dhënat, sipas nevojës, mund të plotësohen ose ndryshohen në mënyrë manuale.

monografi	seriale
trasferimi në mënyrë automatike i kodit të institucionit dhe numrit të kopjeve	transferimi në mënyrë automatike i datës së raportimit, kodit të institucionit, numrit të kopjeve, treguesit të pasurimit, plotësisë, vitit të botimit, shënimit për gjendjen e koleksioneve, mënyrës së pasurimit, furnizuesit, çmimit (nga fatura) dhe financuesit
trasferimi në mënyrë automatike i kodit të institucioneve të tjera dhe numrave të kopjeve	transferimi në mënyrë automatike i datës së raportimit, i kodeve të institucioneve, numrit të kopjeve, treguesit të pasurimit, plotësisë, vitit të botimit, shënimit për gjendjen e koleksioneve, mënyrës së pasurimit, furnizuesit, çmimit (nga fatura) dhe financuesit

## Përshkrimi bibliografik +

998 □□ **b50300 c0**998 □□ **b40017 c0**998 □□ **b40034 c0**998 □□ **b70001 c0**998 □□ **b80002 c0**

## Përshkrimi bibliografik +

998 □1 **a19920228 b40001 c0 gc1 k1990/1991 va 2ebSCO 3EUR 199 4Fmk/P100**998 □1 **a19910208 b50300 c0 gc2 k1950/1951-1960/1961 gc1 k1961/1962 gc2 k1964/1965-1987/1988 k1989/1990- va 2swets 3 EUR 202 4F50300\P100**998 □1 **a19900502 b40013 c0 gc9 k1950/1951- va 2mk 3 EUR 200 4Fmzt\P100**998 □1 **a19920503 b50001 c0 gc2 k1950/1951-1990/1991 va 2mk 3 EUR 205,50 4F50001\P40 4Fmk\P60**998 □1 **a19900201 b60001 c0 gc2 k1950/1951- va 2mk 3 EUR 220 4Fmzt\P100**

Për monografitë në nivelin e përbashkët transferohet vetëm nënfusha 998b dhe 998c, ndërsa për seriale transferohen edhe nënfushat 998aegkmv234. Nga nënfusha 998g transferohet vetëm elementi *c* – *plotësia*.

Nënfusha 998e shtohet në mënyrë automatike në bazë të të dhënave në nënfushën 998k dhe përmban shenjën që tregon se seriali është porositur në vitin aktual. Nënfusha përdoret kryesisht për kërkim. Në nivelin e detajuar (997 dhe 996) vendoset shenja e nënvendndodhjes, në të cilën materiali është rivendosur dhe data e rivendosjes.

## MADHËSIA E TË DHËNAVE NË NIVELIN LOKAL

Të dhënat për gjendjen e koleksioneve vendosen në bazat lokale të të dhënave të institucioneve të veçanta. Në bazë të këtyre të dhënave në mënyrë automatike transferohen dhe mblidhen të dhënat në nivelin e përbashkët.

Vendosja e të dhënave në bazat lokale mund të bëhet në disa mënyra, varësisht nga funksionet, të cilat dëshirojnë t'i automatizoj institucioni.

Vendosja e të dhënave mund të bëhet në tri nivele:

- 998 – Të dhënat përmbledhëse për gjendjen e koleksioneve,
- 997 – Të dhënat për gjendjen e koleksioneve të serialeve,
- 996 – Të dhënat për gjendjen e koleksioneve të monografive.

Funksioni i të dhënave për gjendjen e koleksioneve në fushën 998 është vetëm informues (*COBISS+*, koordinimi i pasurimit...), ndërsa për automatizimin e funksioneve lokale duhet që të dhënat për njësitë e veçanta fizike apo të dhënat për vitet e veçanta të vendosen në fushën 996 apo 997.



---

# 998 TË DHËNAT PËRMBLEDHËSE PËR KOLEKSIONET

Për shkak të *COBISS+* dhe koordinimit të pasurimit me serialet e huaja, të dhënat përmbledhëse vendosen në bazën lokale në fushën 998. Në nivelin e përbashkët transferohen vetëm këto të dhëna:

## monografi

- b** kodi i institucionit
- c** numri i kopjeve

## seriale

- a** data e raportimit
- b** kodi i institucionit
- c** numri i kopjeve
- e** treguesi i pasurimit
- g** të dhënat e përgjithshme për koleksionet (plotësia)
- k** viti i botimit
- n** shënime për gjendjen e koleksioneve
- v** mënyra e pasurimit
- 2** furnizuesi
- 3** çmimi (nga fatura)
- 4** financuesi

Në kuadër të një përshkrimi të veçantë bibliografik për secilin institucion (kod) është në dispozicion një fushë 998. Për monografitë janë të detyrueshme nënfushat 998b dhe 998c, ndërsa për serialet nënfushat 998abcgk. Për serialet e huaja, të cilat janë subjekt i koordinimit të pasurimit, janë të detyrueshme edhe nënfushat 998v234. Nënfusha 998e shtohet në mënyrë automatike në bazë të të dhënave në nënfushën 998k.

Nëse institucioni vendos të dhëna për njësitë e veçanta fizike të monografive në fushën 996, fusha 998 me të dhënat për kodin dhe numrin e kopjeve krijohet në mënyrë automatike. Nënfusha 998c për monografitë ekziston vetëm në nivelin e përbashkët dhe të gjitha elementeve (përveç elementit 7) vlerat u përcaktohen në mënyrë automatike.

Te serialet fusha 998 shtohet në mënyrë automatike në modulën COBISS3/Serialet. Nëse nuk përdoret moduli COBISS3/Serialet, sa herë që në regjistrim për herë të parë shtohen të dhënat e hollësishme për koleksionet – fusha 997, hapet redaktuesi i fushës 998, ku e dhëna vendoset në mënyrë automatike në nënfushën 998b (kodi i institucionit) dhe në nënfushën 998c (numri i kopjeve). Fusha e re 998 duhet të

vendoset në mënyrë manuale në këto raste: kur për koleksionet e bibliotekës që nuk ndodhet në COBISS, raporton një bibliotekë tjetër që ndodhet në sistem; ose kur biblioteka koleksionet për atë regjistrim i administron në një sistem tjetër jashtë COBISS-it; ose kur biblioteka koleksionet i administron në një regjistrim tjetër në kuadër të COBIB-it.

Tek vendosja e të dhënave për institucionet e tjera (kodet) vlenë kufizimi, që vetëm një institucion raporton për koleksionet e institucionit tjetër. Në nënfushën 998c (numri i kopjeve) mund të shënohen dy numra, të cilët ndahen me presje – numri i kopjeve për huazim jashtë bibliotekës dhe numri i kopjeve për huazim në sallë të leximit. Tek vendosja e të dhënave për gjendjen e koleksioneve për institucionin tjetër (kodet) në fushën 998 vendoset numri i vendit në formë pastrukturuar (pa respektimin e elementeve të nënfushës 998d). Nëse janë disa numra të vendit, ata vendosen në formën e pastrukturuar në të njëjtën nënfushë 998d, të ndarë mes vete me cilëndo shenjë pikësimi. E dhëna ka vetëm kuptim informues në nivelin lokal dhe transferohet në nivelin e përbashkët.

Gjithashtu, sa herë që tek burimi i integruar, regjistrimit për koleksionet ose për veprën e ekzekutuar i shtohet fusha e parë 997, hapet redaktuesi i fushës 998, ku e dhëna shënohet në mënyrë automatike në nënfushën 998b (kodi i institucionit) dhe në nënfushën 998c (numri i kopjeve).

998 □1 a19910215 b50124 c3 d1234 sl, 3214, II 314

monografi	seriale
formimi në mënyrë automatike i kodit të institucionit dhe numrit të kopjeve	formimi në mënyrë automatike i kodit të institucionit, shënimi i datës së raportimit, numrit të kopjeve, plotësisë, vitit të botimit, shënimeve për gjendjen e koleksioneve, mënyrës së pasurimit, furnizuesit, çmimit (nga fatura) dhe financuesit
shënimi i kodeve të tjera dhe i numrit të kopjeve	shënimi i datës së raportimit, kodeve të tjera, numrit të kopjeve, plotësisë, vitit të botimit, shënimeve për gjendjen e koleksioneve, mënyrës së pasurimit, furnizuesit, çmimit (nga fatura) dhe financuesit

Përshkrimi bibliografik +

998 □□ b40001 c0 dI 7654

998 □□ b40017 c0 dSL II 9876

998 □□ b40034 c0 d681.3 KOM

Përshkrimi bibliografik +

998 □1 a19880506 b50300 c0 dSL II 389 gc1 k1950/1951-

998 □1 a19910214 b40011 c0 dK I 930 gc2 k1950/1951-1960/1961 gc1 k1961/1962 gc2 k1964/1965-1980/1981 k1982/1983-1987/1988 k1989/1990-

998 □1 a19920502 b40013 c0 dII 8906 gc2 k1950/1951-

Tek raportimi i të dhënave për plotësinë e serialeve (elementi *c* – *plotësia* i nënfushës 998g) për nivelin e përbashkët, që ka të bëjë me një ose disa vite të botimit, rekomandohet plotësimi i nënfushës 998k në FORMË SA MË TË NGJESHUR.



---

# 997 TË DHËNAT PËR GJENDJEN E KOLEKSIONEVE TË SERIALEVE

Të dhënat në këtë fushë vendosen vetëm për "koleksionet tuaja", për nevojat e huazimit dhe automatizimit të evidencave të brendshme. Në fushë mund të vendosen të gjitha të dhënat (shih *Shtojca A*), përveç datës së raportimit dhe kodit të institucionit (997a dhe 997b).

Gjatë procesit të inventarizimit të serialeve, zakonisht çdo vit (volume) merr një numër inventari. Botimet, tek të cilat një vit (volume) del për disa vite radhazi, gjithashtu kanë vetëm nga një numër inventari, sepse të gjithë numrat e këtyre botimeve inventarizohen si një njësi. Tek çdo ndryshim i numërtimit – niveli i dytë (zakonisht viti) fusha 997 duhet të përsëritet. Fusha 997 përsëritet edhe pas çdo ndryshimi të numërtimit në nivelin e tretë.

Shembull 1: Ndryshimi i numërtimit – niveli i dytë (997j)

Të dhënat bibliografike + 998 +

997	21	<b>d</b> /P\5\n12388\s1982/1983 f800001120 <b>j</b> Vol.\1 <b>k</b> 1982/1983 <b>mno.</b> \1-10 <b>va</b> 2mk
997	21	<b>d</b> /P\5\n12388\s1983/1984 f800003300 <b>j</b> Vol.\2 <b>k</b> 1983/1984 <b>mno.</b> \1-10<nr. 9 është e dëmtuar > <b>va</b> <b>nnë</b> dosje, pjesërisht e dëmtuar 2mk
		...
		...
997	21	<b>d</b> /P\5\n12388\s1991/1992 f800007889 <b>j</b> Vol.\10 <b>k</b> 1991/1992 <b>mno.</b> \1-2,4<për nr. 3 është dërguar rekl.> <b>q3</b> <b>va</b> zj234\k19900405 2mk 3EUR 8,00

Shembull 2: Ndryshimi i numërtimit – niveli i dytë (997j) dhe i numërtimit – niveli i tretë (997l)

Të dhënat bibliografike + 998 +

997	21	<b>d</b> /P\n21382\s1988/1 f300000715 <b>IVit.</b> \5 <b>jlib.</b> \1 <b>k</b> 1988 <b>mnr.</b> \1-6
997	21	<b>d</b> /P\n21382\s1988/2 f300000927 <b>IVit.</b> \5 <b>jlib.</b> \2 <b>k</b> 1988 <b>mnr.</b> \1-6
997	21	<b>d</b> /P\n21382\s1989/1 f300001302 <b>IVit.</b> \6 <b>jlib.</b> \1 <b>k</b> 1989 <b>mnr.</b> \1-6
997	21	<b>d</b> /P\n21382\s1989/2 f300001577 <b>IVit.</b> \6 <b>jlib.</b> \2 <b>k</b> 1989 <b>mnr.</b> \1-6
		...
		...
997	21	<b>d</b> /P\n21382\s1991/1 f300002903 <b>IVit.</b> \8 <b>jlib.</b> \1 <b>k</b> 1991 <b>mnr.</b> \1-6
997	21	<b>d</b> /P\n21382\s1991/2 f300002997 <b>IVit.</b> \8 <b>jlib.</b> \2 <b>k</b> 1991 <b>mnr.</b> \1-6

Të gjitha të dhënat mirëmbahen kryesisht për vitin aktual, që do të thotë se pas raporteve periodike (vjetore, tremujore...) disa të dhëna mund të fshihen. Se cilat të dhëna do të fshihen pas përfundimit të raportit (p.sh. pas përgatitjes së librit të inventarit) dhe vet procesi i fshirjes, përcaktohet gjatë fazës së implementimit.

Për shkak të racionalizimit të procedurës së vendosjes së të dhënave dhe për shkak të përdorimit sa më racional të kapaciteteve kompjuterike në nivelin lokal, të dhënat më të frekuentuara vendosen në formë të ngjeshur. Një shembull i tillë është nënfusha 997m (numërtimi – niveli i parë) tek serialet, e në mënyrë të veçantë kjo vlenë për gazetat.

Në të gjitha nënfushat, të cilat përdoren për vendosjen e të dhënave numerike dhe të dhënave që kanë të bëjnë me kornologjinë e serialeve (nënfushat 997jklm), mund të vendosen shënimet publike (*COBISS+*) midis simboleve "< >" dhe shënimet e brendshme midis simboleve "<< >>" (p.sh. mno.\1-13<nr. 11 është e dëmtuar>).

---

# 996 TË DHËNAT PËR GJENDJEN E KOLEKSIONEVE TË MONOGRAFIVE

Të dhënat për njësitë e veçanta fizike të monografive vendosen në fushën 996.

Të dhënat bibliografike + 998 +

- 996 □1 **df2\n12345 f000003145 xb78/6\e19900104 yg678/h19900405  
1m1234\q19900407 2mk 3EUR 100**
- 996 □1 **df2\n12345\da f000003146 xb78/6\e19900104 yg678/h19900405  
1m1234\q19900407 2mk 3 EUR 100**
- 996 □1 **df2\n12345\db f000003147 xb78/6\e19900104 yg678/h19900405  
1m1234\q19900407 2mk 3 EUR 100**
- 996 □1 **df2\n12345\dc f000003148 xb78/6\e19900104 yg678/h19900405  
1m1234\q19900407 2mk 3 EUR 100**
- 996 □1 **df2\n12345\dd f000003149 xb78/6\e19900104 yg678/h19900405  
1m1234\q19900407 2mk 3 EUR 100**
- 996 □1 **df2\n12345\de f000003190 xb78/6\e19900214 yg678/h19900507  
1m1234\q19900512 2dzs 3 EUR 120**



---

# 99X TË DHËNAT PËR GJENDJEN E KOLEKSIONEVE

## LISTA E FUSHAVE

- 996 Të dhënat për koleksionet e monografive
- 997 Të dhënat për koleksionet e serialeve
- 998 Të dhënat përmbledhëse për koleksionet e bibliotekës

Fushat 996, 997 dhe 998 janë të përsëritshme. Shumica e nënfushave në fushat 996, 997 dhe 998 janë të njëjta si për nga përmbajtja që vendoset në to ashtu edhe nga mënyra e shënimit të të dhënave. Për këtë arsye, në manualin *COMARC/H* nuk është përshkruar çdo fushë me nënfushat përkatëse, mirëpo është bërë vetëm një përshkrim i nënfushave sipas renditjes alfabetike, pavarësisht nga fushat. Tek përshkrimi i nënfushave të veçanta vendosen edhe karakteristikat e mundshme, që vlejné për nënfushën e një fushe të caktuar.

Titulli i nënfushës tregon se në cilat fusha (996, 997 ose 998) mund të shtoni nënfushën e caktuar. Shenja 99X në titullin e nënfushës domethënë se ajo nënfushë mund të shtohet në të trija fushat – 996, 997 dhe 998, ndërsa shenja 996/997 në titullin e nënfushës domethënë se ajo nënfushë mund të shtohet vetëm në fushën 996 dhe 997.

Disa nënfusha kanë dy apo më shumë elemente. Shenja e elementit përbëhet nga një karakter, i cili mund të jetë shkronjë ose numër. Para çdo elementi në nënfushë ndodhet shenja ndarëse "\", pas të cilës vije shenja e elementit dhe pas saj përmbajtja – e dhëna. Shenja e elementit të nënfushës dhe shenja ndarëse "\" duhet të vendosen në mënyrë manuale (shih shembullin 1).

## Nënfushat & elementet

### shenja dhe emri i nënfushës

#### shenja dhe emri i elementit

---

- a** Data e raportimit
- b** Kodi i institucionit
- c** Numri i kopjeve/Kopja/njësitë e kompletit
- d** Numri i vendit (Vendosja)
  - I** Shenja e nënvendndodhjes në numrin e vendin

**shenja dhe emri i nënfushës****shenja dhe emri i elementit**


---

<b>f</b>	Formati
<b>n</b>	Numri në vazhdim
<b>s</b>	Numërtimi në numrin e vendit
<b>x</b>	Numërtimi në numrin e vendit - shenja e vëllimit
<b>d</b>	Dublikatë
<b>i</b>	Vendndodhja në raft
<b>u</b>	KDU qasja e lirë
<b>a</b>	ABC dhe shenja të tjera – pjesa 1
<b>5</b>	ABC dhe shenja të tjera – pjesa 2
<b>e</b>	Rivendosja e materialit
<b>E</b>	Shenja e nënvendndodhjes
<b>D</b>	Data e rivendosjes së materialit
<b>e</b>	Treguesi i pasurimit
<b>f</b>	Numri i inventarit
<b>g</b>	Të dhënat e përgjithshme për koleksionet
<b>t</b>	Lloji i njësisë
<b>o</b>	Forma fizike
<b>c</b>	Plotësia
<b>p</b>	Rregullsia
<b>r</b>	Ruajtja
<b>h</b>	Titulli i njësisë
<b>i</b>	Madhësia e njësisë
<b>j</b>	Numërtimi - niveli i dytë (viti/vëllimi)
<b>k</b>	Viti i botimit
<b>l</b>	Numërtimi - niveli i tretë
<b>m</b>	Numërtimi - niveli i parë (numri)
<b>n</b>	Shënime për gjendjen e koleksioneve
<b>o</b>	Data e inventarizimit
<b>p</b>	Shkalla e disponueshmërisë
<b>q</b>	Statusi
<b>r</b>	Shënime për inventarin
<b>s</b>	Lidhja
<b>t</b>	Data e statusit
<b>u</b>	Kufizimi i disponueshmërisë
<b>v</b>	Mënyra e pasurimit

**shenja dhe emri i nënfushës****shenja dhe emri i elementit**

- 
- w** Qëllimi i pasurimit
  - x** Numri dhe data e porosisë
    - b** Numri i porosisë
    - e** Data e porosisë
    - X** Shënimi për porosinë
  - y** Numri dhe data e pranimit
    - g** Numri i fletëdërgesës/listës
    - h** Data e fletëdërgesës/listës
  - z** Numri dhe data e reklamimit
    - j** Numri i reklamimit
    - k** Data e reklamimit
    - Z** Shënimi për reklamimin
  - 0** Numri dhe data e faturës paraprake
    - S** Numri i faturës paraprake
    - G** Data e faturës paraprake
    - C** Çmimi i faturës paraprake
  - 1** Numri dhe data e faturës
    - m** Numri i faturës
    - q** Data e faturës
  - 2** Furnizuesi
  - 3** Çmimi (nga fatura)
  - 4** Financuesi
    - F** Financuesi
    - P** Përqindja e financimit
  - 5** Lloji i përpunimit (orientimi)
  - 7** Numri i brendshëm dhe data e faturës
    - 1** Numri i faturës
    - 2** Data e faturës
  - 8** Pranuesi për dhuratë ose këmbim
    - 3** Emri i institucionit
    - 4** Data e dërgimit
  - 9** Numri për huazim

## Treguesit

TREGUESI	VLERA	KUPTIMI		
1		<b>Treguesi i lidhjes</b>		
	0	<i>numra të palidhur</i> Shprehja në nënfushën 997m është shënuar në formë të ngjeshur, mirëpo algoritmi i huazimit dhe algoritmet e tjera i njohin në mënyrë automatike numrat e veçantë të kopjeve.		
	1	<i>numra të lidhur dhe të palidhur</i> Shprehja në nënfushën 997m përfshinë numrat e lidhur dhe të palidhur. Njësitë (e lidhura ose të palidhura), të cilat mund të huazohen janë të ndara me shenjën "+".		
	2	<i>numra të lidhur</i> Shprehja në nënfushën 997m nuk mund të zgjerohet për nevojat e huazimit (të gjitha numrat janë të lidhur së bashku).		
2		<b>Treguesi i vendosjes</b>		
		<b>SIG1</b>	<b>SIG2</b>	
	1 <sup>1</sup>	LAT	LAT	<i>vendosja sipas numrit në vazhdim</i> Materiali është i vendosur sipas numrave në vazhdim (numerus currens).
	3	LAT	CIR	
	5	CIR	LAT	
	7 <sup>1</sup>	CIR	CIR	
	2 <sup>1</sup>	LAT	LAT	<i>vendosja sipas lëndës</i> Materiali është i vendosur sipas lëndës (p.sh. KDU qasja e lirë) dhe sipas renditjes alfabetike të autorit /titullit.
	4	LAT	CIR	
	6	CIR	LAT	
8 <sup>1</sup>	CIR	CIR		

*Legjenda:*

**SIG1** lloji i përcaktuar i shkrimit në shfaqjen e elementit l dhe i të nënfushës 996/997d, në shfaqjen e elementit E të nënfushës 996/997e dhe shfaqjen e nënfushës 998d

**SIG2** lloji i përcaktuar i shkrimit në shfaqjen e elementeve të nënfushës 996/997d, përveç elementit l, i dhe f, elementit E në nënfushën 996/997e dhe nënfushën 998d

Treguesi 1 përdoret vetëm tek vendosja e të dhënave për serialet. Tek vendosja e të dhënave për monografitë ai nuk është i përcaktuar.

Treguesi 2 për fushën 998 të monografive nuk është i përcaktuar.

---

1 Treguesit e paraparë për fushën 998 të serialeve.



## SHEMBUJ

1.

996	□1	<b>d/H\</b> f2\n146177 <b>f</b> 100002281 <b>o</b> 19981222 <b>va</b> <b>1m</b> 49100366091\q19981222 <b>3EUR</b> 77,07 <b>2mk</b> (Nënfusha 996d – Numri i vendit (Vendosja) përbëhet nga elementi 1, f dhe n; ndërsa nënfusha 9961 –Numri dhe data e faturës nga elementi m dhe q.)
-----	----	--

2.

200	0□	<b>a</b> Hamleti <b>f</b> Uiliam Shekspir <b>g</b> [Parathënie Besart Shala <b>gpërktheu</b> Drita Radi]
675	□□	<b>a</b> 820-21 <b>c</b> 821.111
700	□1	<b>a</b> Shekspir <b>b</b> Uiliam <b>4070</b>
996	□4	<b>d</b> /PON\isp\u821A-SH\aSHEKSPIR U.\5Hamleti <b>f</b> 000013251 <b>o</b> 20060419 <b>va</b> (Shfaqja e nënfushës 996d: PON sp 821A-III ШЕКСПИР В. Хамлет)

3.

200	0□	<b>a</b> Hamleti <b>f</b> Uiliam Shekspir <b>g</b> [Parathënie Besart Shala <b>gpërktheu</b> Drita Radi]
675	□□	<b>a</b> 820-21 <b>c</b> 821.111
700	□1	<b>a</b> Shekspir <b>b</b> Uiliam <b>4070</b>
996	□3	<b>d</b> /PON\isp\2\n23567\s2-2f <b>f</b> 000013251 <b>o</b> 20060419 <b>va</b>
996	□3	<b>d</b> /PON\isp\2\n23567\s2-2f\da <b>f</b> 000013251 <b>o</b> 20060419 <b>va</b>
996	□3	<b>d</b> /PON\isp\2\n23567\s2-2f\db <b>f</b> 000013251 <b>o</b> 20060419 <b>va</b> (Shfaqja e nënfushës 996d: PON sp II 23567/2-2φ a-б)

4.

200	1□	<b>a</b> Regjistri kombëtar i barërave <b>fredaktor</b> përgjegjës Antigona Rrusta
207	□0	<b>a</b> 2006–
530	1□	<b>a</b> Regjistri kombëtar i barërave
675	□□	<b>a</b> 615 <b>s</b> 61 <b>b</b> 615 <b>c</b> 615
997	07	<b>c</b> 1 <b>d</b> /CO\ip\2\n2771\s2006 <b>f</b> 100602457 <b>k</b> 2006 <b>o</b> 20060206
997	07	<b>c</b> 2 <b>d</b> /CO\ip\2\n2771\s2006\da <b>f</b> 100602459 <b>k</b> 2006 <b>o</b> 20060206
997	07	<b>c</b> 3 <b>d</b> /CO\ip\2\n2771\s2006\db <b>f</b> 100602461 <b>k</b> 2006 <b>o</b> 20060206 <b>p</b> 7
998	□7	<b>a</b> 20060206 <b>b</b> 70000 <b>c</b> 0 <b>d</b> CO p *II 2771 –a,b <b>gc</b> 1 <b>k</b> 2006- <b>vd</b> <b>eo</b> (Shfaqja e nënfushës 997d: ЦО n II 2771/2006 a-б Shfaqja e nënfushës 998d: ЦО n II 2771 a-б )



## 998 a – DATA E RAPORTIMIT

Me këtë të dhënë raportohet për përditësimin e të dhënave rreth gjendjes së koleksioneve për nevojat e katalogut online. Vendoset në fushën 998 – *Të dhënat përmbledhëse për koleksionet*, dhe atë vetëm për serialet dhe është e detyrueshme.

Përmes kësaj date tregohet data e vlefshmërisë së të dhënave për koleksionet e vendosura në fushën 998. Për çdo ndryshim apo përditësim të të dhënave për gjendjen e koleksioneve në fushën 998 duhet të vendoset data përkatëse në nënfushën 998a.

Data vendoset në formën "DD.MM.VVVV", ndërsa sipas standardit ISO 2014 transferohet në formën "VVVVMMDD".

Nënfusha 998a nuk plotësohet për monografitë.

### Elementet & gjatësia

Nënfusha nuk ka elemente.

## SHEMBUJ

1.

998 □1 a19920512 b50001 c0 dII 199178 gc9 k1967- vd
---



## 998 b – KODI I INSTITUCIONIT

Për nevojat e katalogut online përdoren të dhënat për institucionet, të cilat përditësohen në bazat lokale të të dhënave dhe në bazën e përbashkët COBIB brenda shërbimit bibliografik.

Kodi identifikon bibliotekat apo organizatat në lidhshmëri, të cilat bashkëveprojnë në sistemin autonom (kombëtar) bibliotekar të informacionit COBISS në kuadër të rrjetit rajonal COBISS.net.

Kodi përcakton njësinë (bibliotekën, qendrën e informacionit etj.) institucionale, e cila përditëson të dhënat në bazën lokale të të dhënave. Nëse njësi institucionale është e ndarë në disa vendndodhje fizike, për caktimin e nënvendndodhjeve dhe mikrovenndodhjeve përdoret e dhëna *l - nënvendndodhja* në kuadër të nënfushës *99Xd – Numri i vendit (Vendosja)*.

Kodi përbëhet nga pesë numra, ku numri i parë identifikon shtetin në sistemin bibliografik COBISS.net.

Përveç kodit, në bazën e të dhënave COLIB ndodhen edhe këto të dhëna për bibliotekat që janë pjesë e sistemit COBISS:

- emri i institucionit/bibliotekës në gjuhën e institucionit dhe në gjuhën angleze,
- titulli,
- akronimi në sistemin COBISS,
- lloji dhe statusi i bibliotekës,
- departamentet (emri i departamentit, telefoni, faksi, posta elektronike),
- orari i punës,
- anëtarësia në sistemin COBISS,
- faqja elektronike (URL),
- numri tatimor,
- personi i kontaktit për COBISS, personat e tjerë përgjegjës.

Nëse raportohet edhe për gjendjen e koleksioneve të institucioneve të tjera, në fushë e përsëritshme 998, në nënfushën 998b vendoset kodi i institucionit.

### Elementet & gjatësia

Nënfusha nuk ka elemente.

### SHEMBUJ

1.

998	□1	a19910215	b50001	c0	gc2	k1980-
-----	----	-----------	--------	----	-----	--------

2.

998 □1 a19910205 b50053 c0 g1 k1982-
--------------------------------------

3.

Shteti / republika / krahina		Kodi
Bosnja dhe Hercegovina	Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Bosnjës dhe Hercegovinës	10000
Mali i Zi	Biblioteka Kombëtare "Đurđe Crnojević" e Malit të Zi	20001
Kroacia	Institut i Shkencave të Informacionit të Universitetit të Zagrebit	31339
Maqedonia	Biblioteka Kombëtare dhe Universitare "Sv. Kliment Ohridski"	40001
Sllovenia	Biblioteka Kombëtare dhe Universitare	50001
Bullgaria	Biblioteka Kombëtare "Sv. sv. Kiril i Metodî"	60000
Serbia	Biblioteka Kombëtare e Serbisë	70000
Vojvodina	Biblioteka Matice serbe	80017
Shqipëria	Akademia e Shkencave e Shqipërisë	92001
Kosova	Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës	90201

## 996/997 c – IDENTIFIKUESI I KOPJES/NJËSISË SË KOMPLETIT

Në nënfushën 996/997c vendoset identifikuesi i kopjes. Kur janë disa kopje të serialit, shënimi i identifikuesit të kopjes është i domosdoshëm (shih shembullin 1).

Nëse një njësi e monografisë është pjesë e kompletit, identifikuesi i njësisë së kompletit vendoset në mënyrë automatike, ndërsa identifikuesi i kopjes, i cili është vendosur në mënyrë manuale, fshihet dhe nuk mund të ndryshohet.

Në fushën 996 për njësinë e kompletit, nënfushën 996c e përbëjnë elementet që përmbajnë identifikuesin e njësisë së kompletit (shih shembullin 2).

### Elementet & gjatësia

Nënfushën 996c për njësinë e kompletit e përbëjnë katër elemente. Vlera e tre të parëve përcaktohet në mënyrë automatike në bazë të të dhënave për kompletin, elementi i tretë përbëhet nga dy pjesë. Elementi i katërt të monografisë është i zbrazët.

NËNFUSHA/ELEMENTI/PJESA E ELEMENTIT			
c	elementi	pjesa e elementit	Identifikuesi i kopjes/njësisë së kompletit
	1		<i>numri i inventarit i njësisë kryesore</i>
	2		<i>numri rendor i kompletit në regjistrimin bibliografik të njësisë kryesore</i>
	3	pjesa 1	<i>numri rendor i njësisë së kompletit</i>
		pjesa 2	<i>numri i të gjitha njësisive në komplet</i>
	4		<i>identifikuesi i kopjes</i>

Para dhe pas çdo elementi është shenja "#". Nëse elementi përbëhet nga dy pjesë, midis numrave është shenja "/".

Për shkak se vlerat përcaktohen në mënyrë automatike në bazë të të dhënave për kompletin, nuk ka kufizive në gjatësinë e elementit.

### SHEMBUJ

1.

997	01	c1	d/P\28752\s1992/1	f100021903	jVit.\4	k1992	mno.\1-3
997	01	c2	d/P\28752\s1992/2	f100021904	jVit.\4	k1992	mno.\1-3

(Biblioteka merr dy kopje.)

2.

001	□□	an	bm	cm	d0	
215	□□	a1	disketë(PC), 1 videokasetë (VHS,PAL), 2 vëll. (83; 226 str.) dnë kuti, 5 x 25 x 33 cm			

996	□2	<b>c#019940271#1#1/4## d/L\u68\aNITAJ Ardi\5Mentor\zk1 f 019940271 goar va</b>
996	□2	<b>c#019940271#1#2/4## d/L\u68\aNITAJ Ardi\5Mentor\zk2 f019940272 goar va</b>
996	□2	<b>c#019940271#1#3/4## d/L\u68\aNITAJ Ardi\5Mentor\zd f019940273 golf va</b>
996	□2	<b>c#019940271#1#4/4## d/L\u68\aNITAJ Ardi\5Mentor\zv f019940274 gogcc va</b>
996	□2	<b>c#019940275#2#1/4## d/L\u68\aNITAJ Ardi\5Mentor\zk1 f019940275 goar va</b>
996	□2	<b>c#019940275#2#2/4## d/L\u68\aNITAJ Ardi\5Mentor\zk2 f019940276 goar va</b>
996	□2	<b>c#019940275#2#3/4## d/L\u68\aNITAJ Ardi\5Mentor\zd f019940277 golf va</b>
996	□2	<b>c#019940275#2#4/4## d/L\u68\aNITAJ Ardi\5Mentor\zv f019940278 gogcc va</b>

*(Biblioteka disponon dy komplete, që përmbajnë nga dy libra, disketë dhe videokasetë. Libri i parë është njësia kryesore e kompletit.)*



## 998 c – NUMRI I KOPJEVE

E dhëna për numrin e kopjeve ka qëllim informues dhe vendoset për nevojat e COBISS+ dhe koordinimit të pasurimit në fushën 998.

Nënfusha 998c për monografitë ekziston vetëm në nivelin e përbashkët, ndërsa nënfusha 998c për serialet ekziston edhe në nivelin e përbashkët edhe në atë lokal.

Nënfusha e re 998c shtohet atëherë kur për regjistrimin në COBIB, në bazën lokale ekziston së paku një fushë 996/997, e cila mund të llogaritet pjesë e koleksioneve.

Pjesë e koleksioneve nuk llogariten fushat 996/997, të cilat:

- në nënfushën 996/997q kanë statusin "9" – *çregjistruar*
- në nënfushën 996/997d në elementin 1 kanë shenjën e nënvendndodhjes për fondin e teksteve mësimore
- nuk kanë as numrin e inventarit në nënfushën 996/997f e as numrin e vendit (vendosjen) në nënfushën 996/997d. Gjithashtu nuk kanë të plotësuar nënfushën 996/997q ose nënfushën 996/997p.

Nënfusha e re 998c shtohet edhe për regjistrimet për serialet, për të cilat nuk ekziston asnjë fushë 997 dhe lejohet vendosja e të dhënave për koleksionet në mënyrë manuale.

Nënfushën 998c e përbëjnë 9 elemente, vlera e të cilave caktohet në mënyrë automatike (përveç elementit 7) në bazë të të dhënave për kopjet e veçanta të monografive në fushat 996 dhe viteve të veçanta të serialeve në fushat 997.

Biblioteka i redakton në mënyrë manuale të dhënat në nënfushën 998c vetëm në këto raste: kur për koleksionet e bibliotekës që nuk është në COBISS raporton një bibliotekë tjetër, e cila është pjesë e sistemit; ose kur biblioteka koleksionet për regjistrimin e veçantë i udhëheqë në një sistem tjetër jashtë COBISS-it; ose kur biblioteka koleksionet i udhëheq në një regjistrim tjetër brenda COBIB-it. Në raste të tilla në nënfushën 998c, në elementin 7, në mënyrë manuale shënohen dy numra, të cilët mes vete ndahen me presje – numri i kopjeve për huazim jashtë bibliotekës dhe numri i kopjeve për huazim në sallë të leximit.

### Elementet & gjatësia

Nënfusha 998c përbëhet nga 9 elemente. Elementet 1, 2 dhe 7 përbëhen nga dy pjesë.

NËNFUSHA/ELEMENTI/PJESA E ELEMENTIT			
c	elementi	pjesa e elementit	numri i kopjeve
	1	pjesa 1	<i>për huazim – jashtë bibliotekës</i>
		pjesa 2	<i>për huazim – në sallë të leximit</i>
	2	pjesa 1	<i>huazim i kufizuar</i>
		pjesa 2	<i>huazim i kufizuar – në sallë të leximit</i>
	3		<i>duke u përgatitur</i>
	4		<i>nuk është për huazim</i>
	5		<i>porositur</i>
	6		<i>për këmbim ose desideratë</i>
	7	pjesa 1	<i>për huazim – jashtë bibliotekës</i>
		pjesa 2	<i>për huazim – në sallë të leximit</i>
	8		<i>vetëm për shfletim në sallë të leximit</i>

	9	<i>info në bibliotekë ose në faqen elektronike ose ende nuk është shtypur</i>
--	---	---

Në modulën *COBISS3/Koleksionet e bibliotekës* midis attributeve të klasës **Fusha 998** dhe klasës **Materiali** elementet janë paraqiten në këtë strukturë: 0/0,0/0,0,0,0,+0-0,0/0,0,0. Elementet janë të ndara me presje dhe tregojnë numrin e kopjeve të monografive ose numrin e viteve të serialeve (përjashtim përbën elementi 7, tek i cili numri ka kuptimin e numrit të kopjeve të serialit), të cilat i ka biblioteka dhe i jep në huazim me apo pa kufizime, ose huazimi i tyre nuk është i mundur. Nëse elementi përbëhet nga dy pjesë, midis numrave ndodhet shenja "/".

Për shkak se vlerat përcaktohen në mënyrë automatike në bazë të të dhënave në fushat 996/997, nuk ka kufizime për sa i përket gjatësisë së elementit të veçantë.

Kushtet dhe algoritmi për vendosjen e vlerës së elementeve janë paraqitur në tabelën *Mënyra e përditësimit të nënfushës 998c dhe shfaqja e të dhënave për disponueshmërinë e koleksioneve (Tabela 998 c-1)*. Programi me algoritmat për vendosjen e vlerave të elementeve të nënfushës 998c gjithmonë e verifikon kushtin, i cili e plotëson fushën e caktuar 996/997. Çdo kusht përbëhet nga 8 kritere për verifikim:

- ekzistenca e numrit të inventarit në nënfushën 996/997f
- ekzistenca e numrit të vendit (vendosjes) në nënfushën 996/997d
- statusi i vendosur në nënfushën 996/997q
- niveli i disponueshmërisë i vendosur në nënfushën 996/997p
- vlera e vendosur e parametrës (y) për mënyrën e huazimit jashtë bibliotekës në tabelën pq
- vlera e vendosur e parametrës (z) për mënyrën e huazimit në sallë të leximit në tabelën pq
- vlera e përcaktuar e parametrave kohorë të huazimit
- përmbajtja në nënfushën 996/997u

Nëse në tabelë tek ndonjë kriter është vendosur "çfarëdo vlere", ju mund të shënoni çfarë të dëshironi ose ta leni të zbrazët. Mënyra e verifikimit të kushteve është kjo: fillimisht verifikohen kushtet e shënuara në rreshtin e parë të tabelës, nëse ato nuk janë plotësuar vazhdohet me verifikimin e kushteve në rreshtin e dytë etj. Në këtë mënyrë vazhdohet deri në rreshtin e 16-të të kushteve.

Nëse biblioteka është e organizuar sipas departamenteve, vlejnë kushtet dhe algoritmet për vendosjen e vlerave të elementeve të nënfushës 998c në nivelin e përbashkët vetëm për kopjet, të cilat në nënfushën 996/997d në elementin *l* kanë shenjën e nënvendndodhjes me shenjën përkatëse të departamentit sipas listës lokale të kodeve *Nënvendndodhja*.

Në mënyrë automatike ndryshojnë vlerat në elementet përkatëse në nënfushat 998c kur:

- biblioteka shton fushën e re 996 ose 997 ose atë e fshinë
- biblioteka shton ose fshinë numrin e inventarit në nënfushën 996/997f
- biblioteka shton ose fshinë numrin e vendit (vendosjen) në 996/997d
- biblioteka ndryshon nivelin e disponueshmërisë në nënfushën 996/997p
- biblioteka ndryshon statusin në nënfushën 996/997q
